



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:242569  
Datë: 10.03.2023  
Numri i dokumentit: 04065765

**C- IV- 14- 1569**

**Paditës :** P S nga R i përfaqësuar nga av T B nga Gjakova

**Kundër**

**Të paditurës :** NSH „ Modeli ” Agjencia Kosovare e Privatizimit, në Prishtinë Rr. “ Driton Hoxha ” nr.55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva , më dt. 03 mars 2023, mori këtë :

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET** se Dhoma e Posaçme jep pëlqimin për tërheqjen e ankesës së paditësit P S, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PEJ 150- 0043, më dt. 24.01.2014.

**Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 13 janar 2014, pranë DHPGJS, është parashtruar ankesa e paditësit kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH „ M ” PEJ 150-0043, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave në shumën 600.00€ .

Ankesës ja ka bashkangjitur provat :

- Vendimin e Autoritet të Likuidimit PEJ 150- 0043.

Më dt. 26.07.2021 , AKP-ja, përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën e përgjigjes në mbrojtje ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ 150- 0043, me propozim që ankesa/ kërkesa të refuzohet.

Më dt. 01.12.2022, i autorizuari i paditësit dorëzoi parashtresën me të cilën është deklaruar se tërheqë padinë .

### **Arsyetimi ligjor**

#### **Dhoma e Posaçme jep pëlqimin për tërheqjen e padisë .**

Me dispozitën e nenit 34 , paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-086, rregullohet, „.. Paditësi mund ta tërheqë kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme. Me dhënien e pëlqimit të tillë, Dhoma e Posaçme merr parasysh interesin e të gjitha palëve të tjera. Vendimi për dhënien e pëlqimit për tërheqje mund të përfshijë urdhërpagesën për shpenzimet e procedurës nga pala që tërhiqet. Vendimi i tillë nuk e ndalon palën nga parashtrimi i serishëm i kërkesës apo ankesës. ” .

Meqenëse paditësi/ i autorizuari , me parashtresë dt. 01.12.2022, është tërhequr nga ankesa/kërkesa, Dhoma e Posaçme, e Gjykatës Supreme e dha pëlqimin për tërheqje të ankesës/ kërkesës .

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv .

### **Shpenzimet Gjyqësore:**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të heqë shpenzimet e veta të procedurës .

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi nuk mund të parashtrahet ankesë me shkrim, por lejohet që pala të paraqes sërish ankesë/ kërkesë sipas nenit 34, par 1 të Ligjit nr. 06/L-034 .

Numri i lëndës: 2022:242569  
Datë: 10.03.2023  
Numri i dokumentit: 04065765